

TETOR 2024

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Tetor 2024

© Ministria e Financave, 2024

Drejtoria e Përgjithshme e Programimit Makroekonomik dhe Fiskal
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

E-mail: Brixhilda.Nguli@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE _____ **2**

ZHVILLIMET EKONOMIKE _____ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit _____ 3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit _____ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave _____ 5
4. Bilanci i Pagesave _____ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar _____ 7
6. Kredia për Ekonominë _____ 8
7. Oferta e Parasë _____ 9
8. Depozitat sipas Burimeve _____ 10

SEKTORI FISKAL _____ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar _____ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve _____ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal _____ 12

ANEKSI STATISTIKOR _____ **13**

Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit në tetor 2024, arriti në 117.63. Norma vjetore e inflacionit për muajin tetor 2024 ishte 1.89 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin tetor 2024 ishte 90.48 lekë për dollarë dhe 98.68 lekë për euro;
- Normat mesatare të interesit të depozitave në lekë sipas individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit tetor 2024 shënuan normën 1.85 dhe 3.32 përqind;
- Normat mesatare të interesit të huave në lekë sipas individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit tetor 2024 shënuan normën 5.86 dhe 6.75 përqind;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,737,943 milionë lekë në muajin tetor 2024, duke shënuar një rritje prej rreth 3.9 përqind krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të 2024 rezultoi pozitiv, në rritje të mjeteve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën prej rreth 367.2 milionë euro;
- Situata buxhetore për periudhën tetor 2024 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej 70.6 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një sufiçit prej 26.3 miliardë lekë;
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-tetor 2024 arritën në rreth 589.8 miliardë lekë, ose afërsisht 11.1 përqind më shumë se muaji tetor 2023 dhe 100 përqind realizim krahasuar me planin e periudhës;
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë arritën në rreth 519.2 miliardë lekë, ose rreth 7.5 përqind më shumë se muaji tetor 2023 dhe 92.1 përqind realizim kundrejt planit të periudhës;

Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin tetor 2024 shënoi normën 1.9%, duke reflektuar një rënie në krahasim me një vit më parë ku ky ndryshim ishte 3.8%. Ndryshimi mujor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) në muajin tetor 2024, krahasuar me një muaj më parë, ka shënuar rritje me 0.1%. Inflacioni mesatar për periudhën janar-tetor 2024 është 2.2%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

“Ushqime dhe pije joalkolike” me rritje vjetore të çmimit prej +3.1%, duke kontribuar me +1.07 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.9%.

“Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me rritje vjetore të çmimit prej +1.2%, duke kontribuar me +0.23 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.9%.

“Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje”, me rritje vjetore +2.9%, duke kontribuar me +0.22 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.9%.




Fig. 1

Ndryshimet mujore/vjetore të IÇK-së
Burimi: INSTAT

“Pije alkoolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +3.6%, duke kontribuar me +0.18 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.9%.

“Mallra dhe shërbime të ndryshme” me rritje vjetore të çmimit prej +1.9%, duke kontribuar me +0.10 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.9%.

“Veshje dhe këpucë” me rritje vjetore të çmimit prej +3.5%, duke kontribuar me +0.13 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.9%.

“Hotele, kafene dhe restorante” me rritje vjetore të çmimit prej +1.8%, duke kontribuar me +0.10 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.9%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2023	7.2	7.1	5.3	4.6	4.7	4.5	4.2	4.0	4.1	3.8	3.9	4.0
2024	3.4	2.6	2.3	2.1	2.2	2.1	2.1	2.0	1.9	1.9		

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit


Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin tetor 2024 arriti në 98.68 lekë/euro, duke u ulur me 0.68 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit tetor një euro u këmbye me 98.29 lekë. Mbiçmimi i lekut gjatë periudhës janar-tetor 2024 kundrejt dhjetor 2023 është 1.5 përqind.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin tetor 2024 arriti në 90.48 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 1.17 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit tetor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 90.45 lekë/dollarë. Mbiçmimi i lekut gjatë periudhës janar-tetor 2024 kundrejt dhjetor 2023 është 1.1 përqind.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan shënoi një nivel mesatar rreth 0.92 dollarë/euro për muajin tetor 2024.


Në krahasim me muajin tetor të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezultojnë se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 6.71 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezultojnë se është mbiçmuar në masën 9.63 përqind. Forcimi i monedhës vendase ndaj euros këtë vit ka ndihmuar në zbutjen e pjeshme të presioneve inflacioniste nga jashtë.

Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, forcimi i lekut mund të shpjegohet me përmirësimet në bilancin e llogarisë korrente, rritjen e investimeve të huaja direkte, me efektet e normalizimit të politikës monetare si dhe si rezultat i stabilitetit të situatës makroekonomike në vend.




3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit tetor 2024, normat mesatare të interesit të depozitave me afat në lekë sipas Individëve dhe Korporatave jo-financiare shënuan përkatësisht normat prej 1.85 dhe 3.32 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave sipas Individëve kanë shënuar rënie me 0.02 pikë përqindje dhe për Korporatat jo-financiare kanë shënuar rritje me 0.64 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë, normat e interesit të depozitave sipas Individëve kanë shënuar rritje me 0.11 pikë përqindje dhe një rritje me 0.83 pikë përqindje për Korporatat jo-financiare.



Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore për muajin tetor 2024 kanë shënuar normën 3.01 përqind, nga 3.11 përqind që shënonte të njëjtën periudhë një vit më parë. Bonoja 12-mujore shënoi rënie me 0.10 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë dhe me një vit më parë .

Gjatë muajit tetor 2024 normat mesatare të interesit të huave sipas Individëve dhe Korporatave jo-financiare shënuan normën 5.86 dhe 6.75 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të huave sipas Individëve ranë me 0.21 pikë përqindje ndërsa normat e interesit sipas Korporatave jo-financiare u rritën me 0.43 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë, kanë shënuar rënie me 0.76 pikë përqindje për Individët dhe rritje me 0.46 pikë përqindje për Korporatat jo-financiare.





4. Bilanci i Pagesave T3-2024

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, Bilanci i përgjithshëm i Pagesave rezultoi pozitiv, në rritje të mjeteve të rezervës valutore në vlerën rreth 367 milionë euro, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2023 që shënoi vlerën 160 milionë euro.

Llogaria korrente u mbyll me balancë pozitive prej rreth 350 milionë euro, lehtësisht e ngushtuar në terma vjetorë me rreth 5 milionë euro, në sfondin e zgjerimit të konsiderueshëm të suficitit tregtar në shërbime. Llogaria kapitale dhe financiare rezultoi në fluks neto dalës, prej rreth -97 milionë euro, krahasuar me -117 milionë euro në tremujorin e tretë të vitit 2023.

Investimet e huaja direkte u vlerësuan në +411 milionë euro, i njëjti nivel me tremujorin e tretë të 2023. Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 262 milionë euro, ose +12.7% krahasuar me +233 milionë euro në tremujorin e tretë të 2023.

Stoku i rezervës valutore, në fund të shtatorit 2024, shënon vlerën prej 5,862 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 6.7 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime dhe rreth 49.2% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.





5. Mjetet Valutare Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit tetor 2024, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N) me rreth 10,286 milionë lekë krahasuar me muajin tetor 2023. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në Bankat Paradepozituese me 14,437 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë, mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 4,005 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 12,213 milionë lekë në Bankën Qendrore.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,737,943 milionë lekë në muajin tetor 2024, duke shënuar një rritje prej 64,759 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 3.9 përqind.

Në muajin tetor, sistemi bankar rezulton me rritje mujore prej 4,742 milionë lekë.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin tetor 2024 arriti në rreth 812,596 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje në vlerë me 82,269 milionë lekë, ose rritje me rreth 11.3 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (58.0%) dhe monedhave të huaja (42.0%).


Gjatë muajit tetor 2024, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 56.3 përqind ose 457,633 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për Individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 38.8 përqind ose rreth 315,080 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 2.2 dhe 2.7 përqind, apo 17,659 dhe 22,197 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin tetor 2024, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 71.9 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 22.9 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.3 dhe 2.9 përqind secili.




7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 401,036 milionë lekë në fund të muajit tetor 2024. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në tetor 2024 ka shënuar një rritje mujore prej 0.01 përqind dhe rënie vjetore prej 0.26 përqind, duke arritur nivelin 23.1 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rritje mujore prej 0.01 përqind dhe rënie vjetore prej 0.43 përqind, duke shënuar nivelin 30.0 përqind.




Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin tetor 2024, kanë shënuar rënie vjetore prej 2,736 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat përbëjnë rreth 72.5 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit tetor 2024 shënuan rritje prej 56,831 milionë lekë në krahasim me muajin tetor 2023. Sektori i individëve në Lekë ka zënë 75.4 përqind të depozitave në lekë.




8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit tetor 2024, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 75.4 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 17.2 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 4.8 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 72.5 përqind dhe rreth 24.5 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 73.8 përqind të totalit.



Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 986,530 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (283,505 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (34,900 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (23,887 milionë lekë) dhe “Qeveria lokale” me rreth 8,085 milionë lekë në totalin e depozitave. Gjatë muajit tetor 2024, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,336,907 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë, niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 3,545 milionë lekë. Ndërsa krahasuar me një vit më parë, totali i depozitave ka shënuar rritje me 54,095 milionë lekë.




Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-tetor 2024 janë mbledhur rreth 589.8 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 519.2 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 463.1 miliardë lekë shpenzimet korrente, nga të cilat rreth 194.7 miliardë lekë shpenzime për fonde speciale.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (pa përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore) dhe Doganave është rreth 379.4 miliardë lekë (99.6% realizim kundrejt planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 34.1 miliardë lekë (6.6% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat nga fondet speciale janë rreth 134.0 miliardë lekë (ose 1.2% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 38.0 miliardë lekë (ose rreth 4.1% më shumë se plani i periudhës).



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 463.1 miliardë lekë, 91.4 miliardë lekë (19.7% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 48.9 miliardë lekë (10.6% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 48.5 miliardë lekë (10.5% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1.1 miliardë lekë (0.23% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 194.7 miliardë lekë (42.1%) për shpenzime për fonde speciale, 55.6 miliardë lekë (12.0% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 22.8 miliardë lekë (4.9% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime të tjera.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-tetor 2024 ishin rreth 589.8 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 547.6 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 38.0 miliardë lekë.

Emërtimi	Tetor'24	Tetor'23	Tetor'24/ Tetor'23 Rritja në (%)
Tatimi mbi Vleren e Shtuar	177,238	161,247	9.9
Tatimi mbi Fitimin	47,074	47,875	-1.7
Akcizat	52,543	48,092	9.3
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	54,912	48,392	13.5
Taksa Nacionale dhe të tjera	40,239	33,651	19.6
Taksa Doganore	7,392	7,524	-1.8

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Dhjetor 2024

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Balanca buxhetore për periudhën janar-tetor 2024 shënoi një vlerë pozitive prej 70.6 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 26.3 miliardë lekë, ndikuar nga rritja më e shpejtë e të ardhurave në raport me planifikimin. Sufiçiti prej 70.6 miliardë lekë u përdor kryesisht për financimin e brendshëm në masën 51.1 miliardë lekë dhe 19.5 miliardë lekë për financimin e huaj.

Për periudhën janar-tetor 2024, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 589.8 miliardë lekë;

- Realizimi i shpenzimeve në masën 519.2 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave progresive për periudhën janar-tetor 2024, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 547.6 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 463.1 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 194.7 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly)					Vjetor (Annual)					Month
	2020	2021	2022	2023	2024	2020	2021	2022	2023	2024	2020	2021	2022	2023	2024	
Janar	1.9	1.3	1.3	1.1	0.5	1.9	1.3	1.3	1.1	0.5	1.5	0.4	3.7	7.2	3.4	January
Shkurt	0.4	1.1	1.3	1.1	0.3	1.1	1.2	1.3	1.1	0.4	1.2	1.1	3.9	7.1	2.6	February
Mars	0.6	0.7	2.4	0.7	0.4	0.9	1.0	1.7	1.0	0.4	2.1	1.2	5.7	5.3	2.3	March
Prill	-0.4	0.2	0.7	0.03	-0.2	0.6	0.8	1.4	0.9	0.3	1.9	1.9	6.2	4.6	2.1	April
Maj	-0.8	-0.9	-0.5	-0.3	-0.2	0.3	0.5	1.0	0.7	0.2	2.1	1.8	6.7	4.7	2.2	May
Qershor	-0.6	-0.8	-0.1	-0.3	-0.4	0.2	0.3	0.9	0.6	0.4	1.8	1.6	7.4	4.5	2.1	June
Korrik	-0.5	0.1	0.2	-0.1	-0.2	0.1	0.2	0.8	0.5	0.3	1.4	2.2	7.5	4.2	2.1	July
Gusht	0.2	0.4	0.8	0.6	0.5	0.1	0.3	0.8	0.5	0.3	1.3	2.4	8.0	4.0	2.0	August
Shtator	0.4	0.5	0.6	0.7	0.6	0.1	0.3	0.7	0.4	0.3	1.5	2.5	8.1	4.1	1.9	September
Tetor	0.2	0.1	0.4	0.1	0.1	0.1	0.3	0.7	0.4	0.3	2.0	2.4	8.3	3.8	1.9	October
Nëntor	-0.5	0.2	-0.3	-0.2		0.1	0.3	0.6	0.3		1.6	3.1	7.9	3.9		November
Dhjetor	0.3	0.8	0.4	0.5		0.1	0.3	0.6	0.3		1.1	3.7	7.4	4.0		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2 **Kursi i këmbimit**
Exchange rate

Monedha					2024	2024	2024	2024	2024	2024	2024	2024	2024	2024	2024	Currency
	2020	2021	2022	2023	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor		
					January	February	March	April	May	June	July	August	September	October		
Mesatarja e periudhës															Average of period	
USD	108.65	103.68	113.04	100.65	95.33	96.29	95.32	94.64	92.98	93.22	92.50	90.78	89.43	90.48	USD	
EURO	123.77	122.37	118.98	108.80	103.91	103.91	103.57	101.48	100.52	100.35	100.31	99.97	99.35	98.68	EURO	
Fundi i periudhës															In the end of period	
USD	100.84	106.54	107.05	93.94	95.95	95.92	95.37	93.77	93.01	93.70	92.58	89.92	88.25	90.45	USD	
EURO	123.70	120.76	114.23	103.88	103.90	103.99	102.87	100.64	100.86	100.31	100.22	99.65	98.77	98.29	EURO	

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3 Normat e Interesit me bazë vjetore (në Lek)
Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2024	2024	2024	2024	2024	2024	2024	2024	2024	2024	In percent
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	
	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	
Norma e Interesit të depozitave për Individë											Interest rates on households deposits
Deri në 1 vit	1.07	1.72	1.70	1.56	1.76	1.67	1.68	1.67	1.64	1.54	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	1.77	2.83	2.84	2.67	2.75	2.78	2.62	1.99	1.98	2.35	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	2.93	3.10	3.22	3.25	3.04	3.08	2.94	2.91	2.77	2.74	Over 2 years
Norma e Interesit të depozitave për korporatat jo-financiare											Interest rates on nonfinancial corporations deposits
Deri në 1 vit	3.01	2.27	1.85	3.35	2.76	2.78	2.70	2.74	2.51	2.82	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	2.49	2.88	3.17	3.38	3.18	3.43	2.89	3.98	3.76	3.87	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	4.69	4.50	4.54	3.77	3.59	3.11	3.74	3.38	3.13	3.32	Over 2 years
Normat e Interesit të kredive per Individet											Interest rates on household loans
Kredi për banesa	4.35	4.75	4.29	4.27	3.95	4.20	4.06	3.66	3.95	3.76	Lending for house purchase
Kredi konsumatore	9.89	9.75	9.34	9.55	9.46	9.40	9.23	9.54	7.74	7.49	Consumer credit
Kredi për qëllime të tjera	10.46	11.08	12.36	12.75	13.12	12.35	10.10	12.24	12.64	10.71	Credit for other purposes
Normat e Interesit të kredive per korporatat jofinanciare											Interest rates on nonfinancial corporations loans
Kredi deri në 140 milion lekë	6.86	6.77	7.06	7.28	7.27	6.90	6.93	6.71	6.92	7.03	Loans up to to an amount of 140 millions of lek
Kredi mbi 140 milionë lekë	7.35	7.01	5.85	5.75	6.60	7.61	6.38	6.37	5.59	6.25	Loans over an amount of 140 millions of lek
Norma e letrave me vlerë											Securities rates
Bono thesari 1/											Treasury bills 1/
3-M	3.09	-	-	3.05	-	-	-	-	-	-	3-M
6-M	-	3.28	-	-	-	3.24	-	3.12	-	-	6-M
12-M	3.48	3.62	3.63	3.69	3.54	3.30	3.19	3.16	3.11	3.01	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2024

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2024
Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	January Janar	February Shkurt	March Mars	April Prill	May Maj	June Qershor	July Korrik	August Gusht	September Shtator	October Tetor	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	54,516	104,291	164,283	287,218	287,085	342,832	402,675	464,297	528,438	589,813	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	170	354	848	1,313	1,487	1,522	2,184	2,374	2,596	4,193	Grants
II.	Të ardhura tatimore	52,589	100,122	158,030	214,706	267,382	321,096	378,390	437,876	491,555	547,575	Tax Revenue
II.1.	Nga Tatimet dhe Doganat	36,346	69,613	111,763	147,285	183,612	222,136	261,500	304,811	341,786	379,398	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	18,310	35,469	51,794	67,054	84,949	102,717	122,253	140,836	158,155	177,238	V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	2,859	5,959	18,651	24,500	27,574	32,592	36,058	39,302	43,364	47,074	Profit Tax
3	Akcizat	4,299	8,553	13,054	17,714	23,125	28,858	34,891	41,888	47,206	52,543	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	5,710	10,484	15,288	21,046	26,778	32,240	38,141	44,913	49,825	54,912	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	4,528	7,858	10,988	14,185	17,662	21,402	24,947	31,886	36,585	40,239	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	639	1,290	1,987	2,787	3,524	4,328	5,210	5,985	6,651	7,392	Customs Duties
II.2.	Të ardhura nga Pushteti Vendor	1,447	3,597	7,064	14,289	18,075	20,833	24,510	27,568	30,936	34,137	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	257	551	1,253	3,168	3,831	4,574	5,103	5,513	6,052	6,656	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	7	12	18	27	38	46	51	56	58	64	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,182	3,034	5,793	11,094	14,206	16,213	19,356	21,999	24,826	27,416	Local Taxes
II.3.	Të ardh nga fondet speciale	14,797	26,912	39,204	53,132	65,695	78,127	92,381	105,497	118,833	134,041	Social Ins. contributions
1	Sigurimi Shoqeror	12,748	23,287	33,981	45,960	56,836	67,521	79,758	91,147	102,681	115,631	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	2,013	3,576	5,150	7,067	8,702	10,294	12,273	13,953	15,652	17,807	Health Insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	35	50	73	105	157	312	350	397	499	603	Compensation income in the value of owners
III.	Të ardhura Jotatimore	1,758	3,814	5,404	15,975	18,349	20,214	22,101	24,047	34,287	38,045	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,023	2,347	3,217	4,783	5,783	6,613	7,432	8,235	17,581	12,276	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	246	477	660	947	1,270	1,548	1,855	2,248	2,445	2,813	Utility fees
4	Të tjera	489	990	1,528	2,327	3,378	4,135	4,840	5,589	6,286	6,981	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	39,090	83,719	131,946	186,413	237,282	291,419	348,316	406,013	459,605	519,227	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	38,576	82,488	125,650	170,676	216,122	264,797	314,687	363,856	411,253	463,076	Current Expenditures
I.1.	Personell	8,461	17,145	25,749	34,418	43,124	51,833	60,993	71,064	81,177	91,431	Personnel expenditures
1	Paga	7,264	14,718	22,082	29,500	36,961	44,397	52,188	60,760	69,406	78,157	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqerore	1,183	2,375	3,558	4,754	5,963	7,167	8,366	9,757	11,160	12,555	Social insurance contributions
3	Arsimi I larte nga te ardhurat e veta	13	53	108	164	200	268	440	546	612	719	Higher education from its own income
I.2.	Interesat	6,870	11,884	16,619	19,666	22,150	29,257	36,171	40,456	44,722	48,937	Interest
1	Të Brendshme	5,767	10,105	13,395	15,609	16,775	17,388	22,924	26,687	29,447	31,819	Domestic
2	Të Huaja	1,103	1,778	3,224	4,057	5,376	11,870	13,247	13,769	15,275	17,118	Foreign
I.3.	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,784	6,067	9,832	15,719	22,059	27,031	31,798	36,291	41,488	48,498	Operational & Maintenance
I.4.	Subveclonant	39	93	210	310	449	546	668	787	915	1,062	Subsidies
I.5.	Shpenzime për fonde speciale	16,709	35,365	53,490	73,214	92,208	111,981	132,099	154,157	173,935	194,738	Social Insurance outlays
1	Sigurime Shoqerore	13,306	26,617	40,673	54,863	69,306	84,204	99,712	116,427	131,875	147,094	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	3,403	8,514	12,475	18,007	22,558	27,432	31,804	37,156	41,462	46,798	Health insurance
3	Fondi I kompensimit të pronarëve	0	234	342	344	344	345	583	574	599	846	Owners' Compensation Fund
I.6.	Shpenzime per Buxhetin Vendor	3,040	7,953	13,416	18,709	25,113	30,999	37,181	43,155	48,836	55,608	Local budget expenditure
I.7.	Shpenzime të tjera	1,674	3,981	6,335	8,640	11,019	13,149	15,777	17,947	20,180	22,802	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	61	134	204	277	348	421	484	557	644	722	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,513	3,507	5,504	7,517	9,544	11,398	13,571	15,489	17,433	19,615	Economic Aid
3	Bonusi I lindjeve	100	300	500	600	800	900	1,100	1,200	1,400	1,600	Birth bonus
I.8.	Transferime Kapitale	0	0	0	20	39	39	46	46	46	196	Capital transfers
II.	Fondi Rezerve, Kontigjenca	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Reserve fund/contingency
III.	Shpenzime Kapitale	514	1,080	6,297	15,717	21,120	26,584	33,584	42,111	48,306	55,955	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	0	95	2,647	10,526	13,679	17,611	21,249	27,450	31,767	36,691	Domestically financing
2	Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte	0	18	59	161	211	270	416	496	589	691	From higher education system's own revenues
3	Financimi Huaj	513	968	3,282	3,982	5,401	6,332	7,985	9,543	10,972	12,996	Foreign financed
IV.	Fondi I rindertimit	0	151	308	1,048	1,828	2,370	3,934	4,623	4,978	5,577	Reconstruction fund
V.	DEFICITI	15,426	20,571	32,336	45,582	49,936	51,412	54,359	58,284	68,832	70,586	CASH BALANCE
V.1.	FINANCIMI DEFICITIT	-15,438	-20,571	-32,336	-45,582	-49,936	-51,412	-54,359	-58,284	-68,832	-70,586	CASH BALANCE FINANCING
V.2.	Brendshëm	-12,195	-14,749	-30,537	-38,112	-41,474	-40,833	-41,240	-43,715	-52,820	-51,112	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	1	2	2	2	3	18	19	25	25	26	Privatization receipts
2	Hua-marrije e brendshme	-12,000	-12,745	-790	-399	13,024	23,864	24,454	26,867	36,887	37,285	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-196	-2,006	-29,749	-37,716	-54,501	-64,714	-65,712	-70,606	-89,732	-88,423	Others
V.3.	I huaj	-3,243	-5,823	-1,799	-7,469	-8,462	-10,580	-13,120	-14,570	-16,013	-19,474	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	348	1,211	3,292	3,776	4,547	5,340	6,136	7,210	8,629	9,622	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	8	-551	-979	-1,200	-718	-589	-364	-41	-227	90	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-3,599	-6,482	-9,344	-15,278	-17,523	-20,563	-24,123	-26,970	-29,647	-34,595	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	0	0	5,232	5,232	5,232	5,232	5,232	5,232	5,232	5,409	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

Tabela e investimeve 2024

Table of investments 2024

Të dhëna progresive (Progressive Data)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	
Financim i brendshëm	-12,195	-14,749	-30,537	-38,112	-41,474	-40,833	-41,240	-43,715	-52,820	-51,112	Domestic financing
Në %	79.0	71.7	94.4	83.6	83.1	79.4	75.9	75.0	76.7	72.4	In %
Financim i huaj	-3,243	-5,823	-1,799	-7,469	-8,462	-10,580	-13,120	-14,570	-16,013	-19,474	Foreign financing
Në %	21.0	28.3	5.6	16.4	16.9	20.6	24.1	25.0	23.3	27.6	In %
Totali	-15,438	-20,571	-32,336	-45,582	-49,936	-51,412	-54,359	-58,284	-68,832	-70,586	Total
Në %	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2024
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2024

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	
	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	
Taksë doganore	639	1,290	1,987	2,787	3,524	4,328	5,210	5,985	6,651	7,392	Customs Duties
TVSH	9,908	21,713	34,282	47,416	61,780	75,262	89,507	102,894	115,150	128,077	V.A.T
Akcizë	4,299	8,554	13,054	17,714	23,125	28,858	34,891	41,889	47,206	52,543	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	187	401	722	996	1,257	1,485	1,642	1,897	2,144	2,371	Others (Mineral Rent)
TOTALI	15,034	31,957	50,045	68,913	89,686	109,933	131,249	152,665	171,151	190,382	Total
TË ARDHURAT TATIMORE 2024 (TAX REVENUE)											
TVSH	8,402	13,757	17,512	19,638	23,168	27,455	32,747	37,942	43,006	49,161	V.A.T
Tatim mbi fitimin	2,859	5,959	18,651	24,500	27,574	32,592	36,058	39,302	43,364	47,074	Profit Tax
